



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.479/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Nevruz Gjocaj, paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të moslejimit të pjesëmarrjes në procesin zgjedhor si komisioner, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e Nevruz Gjocaj.

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Nevruz Gjocaj i cili thekson se nuk i lejohet pjesëmarrja si komisioner në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2010, i cili thekson se më parë ka punuar si vëzhgues, komisioner dhe kryesues i këshillit të vendvotimit. Parashtruesi i ankesës thekson se për herën e fundit ka punuar si kryesues i këshillit të vendvotimit në zgjedhjet lokale në fshatin Novosellë. Parashtruesi i ankesës kërkon që të di perse emri i tij është në listën e zezë të KQZ-se, pasi posedon vendimin e prokurorisë së Kosovës mbi pushimin e hetimeve ndaj tij dhe certifikatën e nga gjykata komunale. I lartpërmenduri kërkon që të analizohet i gjithë dokumentacioni dhe të sugjerohet KQZ-se që ta lejoj pjesëmarrjen e tij si komisioner në zgjedhjet parlamentare.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur certifikatën nga Gjykata komunale e Gjakovës dhe Aktvendimin mbi pushimin e hetimeve të Prokurorisë Publike Komunale të Gjakovës.

Neni 59.2 i LZP-së përcakton se:

KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizo shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e Nevruz Gjocajt paraqitur kundër KQZ-se është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve, përfshirë këtu edhe emërimin e anëtareve të KQZ-ve dhe KVV-ve. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 479/2010 më datën 16.12.2010

